

## PABARAZIA NË KONSUM: NJË ANALIZË BAZUAR NË DEKOMPOZIMIN E KOEFICIENTIT GINI TË SHPENZIMEVE NË SHQIPËRI

Ola Çami, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

### ABSTRAKT

Ky artikull analizon pabarazinë e shpenzimeve të konsumit në Shqipëri nëpërmjet llogaritjes dhe dekompozimit të koeficientit Gini për shpenzimet. Të dhënat janë marrë nga Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) për vitin 2012, e cila ofron të dhëna mbi shpenzimet e familjeve për kategori të ndryshme të produkteve dhe shërbimeve. Rezultatet sugjerojnë për një pabarazi prej 0,371 për konsumin total, përkundrejt pabarazisë prej 0,403 për të ardhurat. Rreth 78% e të gjitha shpenzimeve të familjeve përbëhen nga shpenzimet për ushqim, karburant, energji, ujë dhe mirëmbajtje, duke sjellë që shpenzimet për komponentë të tjerë të shpenzimeve të konsiderohen mallra luksi e për rrjedhojë dekompozimi i koeficientit Gini tregon për pabarazi të lartë relative të këtyre komponentëve.

### HYRJE

Vendimet e konsumit janë përcaktuesit kryesorë të rritjes ekonomike dhe cikleve të biznesit. Si pjesë e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të Shqipërisë, konsumi privat është rritur në mënyrë të qëndrueshme, duke arritur në vitin 2015 në 80% të PBB-së vjetore [INSTAT (2017)]. Në periudha recesioni, si pasojë e pasigurisë së rritur, shpenzimet e konsumatorëve kanë gjasa jo vetëm të bien, por edhe të dëmtojnë perspektivat për rimëkëmbje [Bernanke (1993), Dow dhe Hillard, (1995) dhe (2000), Sordi dhe Vercelli (2010), Bartolucci et al. (2011)]. Megjithatë, konsumi agregat është rezultante e sjelljeve të konsumit në nënpopullata të ndryshme, të cilat nuk mund të merren parasysh në vlerësimet makroekonomike. Në veçanti, heterogjeniteti në përbërjen e popullsisë, së bashku me përqendrimin e të ardhurave dhe pasurisë në majën e shpërndarjes ka të ngjarë të shkaktojë pabarazi në sjelljen e shpenzimeve dhe konsumit në familje të ndryshme.

Koeficienti Gini për të ardhurat konsiderohet një matës i mirë statistikor i pabarazisë dhe mirëqenies [Gini (1936)]. Pabarazia e të ardhurave ka tërhequr shumë interes në literaturën akademike [shih p.sh. Levy dhe Murnane (1992); Burtless (1995); Gottschalk dhe Smeeding (1997)], ndërkohë që pak studime analizojnë pabarazinë e konsumit. Në të vërtetë është e lehtë të argumentohet se mirëqenia e familjes matet në mënyrë më të përshtatshme nga konsumi në vend të të ardhurave. Konsumi mund të jetë një matës më i mirë i të ardhurave të përhershme të familjeve (Meyer dhe Sullivan, 2006), mirëqenies së të varfërve (Meyer dhe Sullivan, 2003), dhe ndryshimet në pabarazinë e të ardhurave kanë implikime të mirëqenies që

varen shumë nga struktura e tregjeve të kreditit dhe sigurimeve (Krueger dhe Perri, 2005).

Në anën tjetër, mjaft studime kanë gjetur se koeficienti Gini për të ardhurat dhe për konsumin janë dy tregues plotësues dhe shfaqin sjellje të ndryshme në periudha të caktuara. Mjaft studime kanë gjetur se pavarësisht se në vite të recesionit dhe krizave, pabarazia në të ardhura ka rënë, pabarazia në konsum është rritur dhe kjo ka sjellë përkeqësim të mirëqenies [Daunfeldt, Folster dhe Hortlund (2007)]. Gjithashtu, mjaft studime thonë se rritja e njërit prej këtyre koeficientëve paralajmëron për një rritje të koeficientit tjetër në të ardhmen: një rritje e Gini-t të konsumit paralajmëron dhe një rritje të Gini-t të ardhurave [Cutler dhe Katz (1992)] dhe e anasjellta [Krueger dhe Perri (2005)].

Ky artikull përdor të dhëna mikro të familjeve për vitin 2012 dhe llogarit pabarazinë në shpërndarjen e shpenzimeve të familjeve, si dhe dekomponon dhe analizon tregues të ndryshëm në bazë të komponentëve të shpenzimeve totale, duke u bazuar në metodologjinë e Garner (1991). Përdorimi i kësaj metodologjie lejon dhe skicimin e formës së kurbave të Engels-it duke qenë se llogaritja e elasticiteteve jep dhe informacion mbi preferencat për komponentët e shpenzimeve e rrjedhimisht edhe mbi pjerrësinë e kurbës së familjeve për secilin prej komponentëve. Një analizë e kësaj natyre jep informacion të nevojshëm plotësues të të kuptuarit të mirëqenies dhe të modeleve të shpenzimeve të familjeve e për rrjedhojë shpjegon më në detaj sjelljen e konsumit agregat, duke i shërbyer informacionit dhe vendimmarrjes së stabilitetit financiar dhe politikës monetare.

Në dy seksionet në vijim paraqitet në mënyrë të detajuar metodologjia dhe të dhënat e përdorura dhe më tej mund të gjenden rezultatet dhe konkluzionet e analizës.

## METODOLOGJIA

Koeficienti Gini përfaqëson një tregues për matjen e pabarazisë në shpërndarjen e shpenzimeve totale të familjeve për popullatën. Formula shprehet në terma të kovariancës mes shpenzimeve totale ( $X$ ), shpërndarjes kumulative [ $F(X)$ ] dhe mesatares së shpenzimeve ( $m$ ) sipas formulës më poshtë:

$$(1) G = \frac{2\text{cov}(X,F)}{m}$$

Koeficienti merr vlera në intervalin  $0 \leq G \leq 1$  ku sa më afër 1 aq më i lartë është niveli i pabarazisë dhe sa më afër 0 aq më i ulët është niveli i pabarazisë. Një vlerë 0 e koeficientit nënkupton barazi të plotë dhe 1 nënkupton pabarazi të plotë.

Metodologjia e përdorur për të përllogaritur dekompozimin e këtij koeficienti mbështetet në metodologjinë e prezantuar nga Lerman dhe Yitzhaki (1984) dhe Garner (1993). Kjo metodologji është përdorur gjerësisht në literaturë dhe është një ndër të paktat metoda, e cila e mat koeficientin Gini në nivel individual (familje) dhe jo grupi. Për efekt krahasimi, duke përdorur formulën e mësipërme është llogaritur dhe koeficienti Gini për të ardhurat totale.

Shpenzimet totale janë dekompozuar në komponentë ( $x_k$ ) në mënyrë të tillë që  $x = \sum_{k=1}^K(x_k)$ . Komponentët e përzgjedhur janë si më poshtë: ushqimi, transporti, argëtimi, alkooli dhe duhani, mirëmbajtja dhe operimi, mobilitet dhe pajisjet, karburanti, energjia dhe uji dhe shpenzime të tjera<sup>1</sup>.  $F_k$  përfaqëson shpërndarjen kumulative të  $x_k$  dhe  $m_k$  përfaqëson mesataren e saj. Si rrjedhojë, koeficienti Gini për komponentin e shpenzimeve "k" mund të përllogaritet nëpërmjet formulës së mëposhtme:

$$(2) \quad G_k = \frac{2\text{cov}(x_k, F_k)}{m_k}$$

Gjithashtu, koeficienti Gini, për totalin e shpenzimeve, mund të llogaritet edhe nëpërmjet formulës së mëposhtme, duke shfrytëzuar shpërndarjet kumulative dhe mesataret e komponentëve të shpenzimeve:

$$(3) \quad G = \frac{2 \sum_{k=1}^K \text{cov}(F, x_k)}{m}$$

Përveç dekompozimit të koeficientit Gini, në këtë artikull, janë përllogaritur edhe komponentët e buxhetit të dekompozuar. Duke shumëzuar dhe pjesëtuar të dy anët e ekuacionit me  $\text{cov}(x_k, F_k)$  dhe  $m_k$  ekuacioni (3) transformohet si më poshtë:

$$(4) \quad G = \sum_{k=1}^K \left( \frac{\text{cov}(x_k, F)}{\text{cov}(x_k, F_k)} \cdot \frac{2\text{cov}(x_k, F_k)}{m_k} \cdot \frac{m_k}{m} \right) = \sum_{k=1}^K R_k G_k S_k = \sum_{k=1}^K C_k$$

Ku,  $R_k$  komponenti i parë i koeficientit Gini shpreh korrelacionin mes shpenzimeve për kategorinë e k-së dhe shpenzimeve totale.  $G_k$  është koeficienti Gini për secilin prej komponentëve të shpenzimeve siç është përkrahur më lart dhe  $S_k$  është kontributi në shpenzime i komponentit të k-të.  $C_k$  paraqet produktin e elementeve të dekompozuar për komponentin e k-së. Çdo ndryshim në variablat  $R_k$ ,  $G_k$ , dhe  $S_k$  do të reflektohet në ndryshimin e  $C_k$ . Sa më e madhe të jetë vlera e njërit prej këtyre komponentëve aq më shumë rritet  $G_k$  aq më shumë rritet pabarazia në shpenzime duke qenë se  $G = \sum_{k=1}^K C_k$ .

Gjithashtu, në këtë artikull llogariten dhe dy matës të efekteve relative të pabarazisë: Pabarazia relative e shpenzimeve, e cila llogaritet si raporti midis

<sup>1</sup> Për një listë më të detajuar të mallrave dhe shërbimeve që përfshihen në secilën kategori referohuni tabelës 2 në shtojcë.

proporcionit të pabarazisë ndaj totalit të shpenzimeve që i atribuohen secilës kategori ( $I_k = C_k/G$ ) me kontributin e shpenzimeve për komponentin e k-së ( $S_k$ , shih formulën 4) dhe efektet marxhinale relative, të cilat llogariten si diferencë e dy elementeve të mësipërme.

Së fundi, për secilën kategori, matet edhe elasticiteti për të përcaktuar nëse këto të mira dhe shërbime perceptohen dhe konsumohen si mallra luksi, të domosdoshme apo inferiore (formula 5):

$$(5) e = \frac{R_k G_k}{G}$$

E cila merr tre vlera: nëse  $e > 1$ , atëherë produkti konsumohet si mall luksi, nëse  $0 < e < 1$  produkti konsumohet si mall i domosdoshëm dhe nëse  $e < 0$  produkti konsumohet si mall inferior. Duke përdorur elasticitetet e komponentëve të konsumit, janë skicuar dhe kurbat e Engels-it për secilin prej komponentëve.

## TË DHËNAT

Të dhënat e përdorura për analizën janë marrë nga Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) për vitin 2012. LSMS-ja është një anketë e zhvilluar nga INSTAT-i me frekuencë 4-vjeçare dhe një kampion prej 6672 familjesh, të cilat japin informacion mbi një sërë çështjesh përfshirë dhe të dhëna mbi shpenzimet e familjeve për kategori të ndryshme të produkteve dhe shërbimeve. Edhe pse të dhënat i përkasin vitit 2012, ato sërish janë të përshtatshme për analizë duke qenë se: 1) teoritë e konsumit sugjerojnë se individit e zbut konsumin e tij përgjatë jetës e veçanërisht në kushte ekonomiko-sociale të pandryshuara, konsumi nuk ka prirjen të ndryshojë drastikisht<sup>2</sup> dhe 2) analiza nuk shqyrton vlerat absolute të shpenzimeve, por mesataret dhe shpërndarjet kumulative të popullatës. Gjithsesi, kjo analizë do të ishte interesante për t'u përsëritur dhe krahasuar me rezultatet aktuale të LSMS-së së fundit.

Ndonëse shumë komponentë të konsumit maten duke përdorur shpenzimet e ekonomive familjare, ka dallime të rëndësishme midis dy koncepteve. Së pari, shpenzimet përjashtojnë konsumin që nuk bazohet mbi transaksionet e tregut. Duke pasur parasysh rëndësinë e prodhimit shtëpiak në vendet në zhvillim, ky mund të jetë një dallim i rëndësishëm. Së dyti, shpenzimet i referohen blerjes së një malli apo shërbimi të caktuar. Megjithatë, malli ose shërbimi nuk mund të konsumohen menjëherë ose mund të ketë përfitime të përhershme. Në analizën e këtij artikulli, do të diskutohet mbi pabarazinë në shpenzime si një përafrim i konsumit, duke qenë se baza e të dhënave nuk lejon akses në konsumin real të familjeve.

Të dhënat mbi shpenzimet e ushqimit brenda dhe jashtë shtëpisë mblidhen në dy periudha prej 14 ditësh në formën e një ditari shpenzimesh për të gjitha familjet. Këto shpenzime janë përfaqësuese të konsumit mesatar mujor të një

<sup>2</sup> Bazuar në implikimet e teorisë së ciklit të jetës së Modigliani, Brumber (1964) dhe Friedman.

familjeje dhe për këtë arsye janë shumëzuar me '26' për të dhënë vlerën e konsumit vjetor të ushqimit. Pyetjet e tjera rreth shpenzimeve grupohen në anketë në tre kategori të mëdha: me frekuencë 1-mujore, 6-mujore dhe 12-mujore, me informacion mbi një sërë produktesh, të cilat për analizën janë grupuar sipas komponentëve të shpenzimeve dhe janë shumëzuar respektivisht me 12, 2 dhe 1 për të dhënë vlerat përkatëse vjetore të konsumit. Konsumi total vjetor është përlogaritur si shuma totale e shpenzimeve në të gjitha kategoritë<sup>3</sup>. Si shpenzimet rreth sigurimit dhe pensionit vullnetar, ashtu edhe shpenzimet për taksa, nuk janë përfshirë në analizë.

Një kufizim që rrjedh nga të dhënat është se sa më shumë raportohet "zero" shpenzime konsumi nga ana e familjeve për një mall ose shërbim aq më i lartë do të jetë koeficienti Gini, pra një mosraportim me dashje nga ana e familjeve do të sillte një rritje artificiale në vlerën e koeficientit. Për të marrë vlera sa më të sakta dhe të paanshme nga kampioni, janë përjashtuar familjet; të cilat nuk i janë përgjigjur asnjërës prej pyetjeve rreth shpenzimeve; ato të cilat i janë përgjigjur pyetjeve rreth ushqimit, por asnjërës nga pyetjet rreth shpenzimeve 1, 6 dhe 12-mujore dhe familjet të cilat nuk u janë përgjigjur pyetjeve rreth shpenzimeve 1-mujore, produktet e të cilave janë të domosdoshme për familjen. Për më tepër, këto përjashtime janë bërë për të shmangur një vlerë artificiale të shpenzimeve totale të familjes. Pas hedhjes poshtë të këtyre observimeve kampioni për analizë rezultoi të jetë një total prej 4987 familjesh, të cilat janë të mjaftueshme për të siguruar rezultate të rëndësishme.

Në anën tjetër, LSMS-ja 2012 nuk ofron të dhëna mbi konsumin total të vetëdeklaruar të familjeve, e cila mund të shërbejë si një pyetje kontrolli mbi rezultatin mbas llogaritjeve dhe të dhëna mbi shpenzimet për strehim të familjeve, të cilat do të ishin shumë të rëndësishme për t'u përfshirë në analizë si komponent i shpenzimeve.

## REZULTATET

Në tabelën 1 paraqiten rezultatet e plota të analizës. Kolona e parë (Ck) është llogaritur duke përdorur kolonën e dytë (Rk), të tretë (Gk) dhe të katërt (Sk). Kolona e pestë (Ik), e gjashtë (Ik/Sk) dhe e shtatë (Ik-Sk) paraqesin efektet relative nga dekompozimi. Kolona e fundit paraqet elasticitetin sipas secilës kategori shpenzimesh.

Së pari, **koeficienti Gini për shpenzimet totale është i barabartë me 0,371**, i cili është më i ulët se **koeficienti i pabarazisë së të ardhurave 0,403** i llogaritur nga e njëjta bazë të dhënash. Pavarësisht se pabarazia është më e madhe në të ardhura, kjo gjë nuk reflektohet në të njëjtën masë në shpenzimet e familjeve e në këtë kuptim, familjet, pavarësisht të ardhurave, mund të shpenzojnë në të njëjtën masë për produkte të caktuara.

<sup>3</sup> Si shpenzimeve janë konsideruar edhe blerjet të cilat janë bërë por pagesa është kryer e pjesëshme ose do të kryhet në një periudhë të mëvonshme (kryesisht në kategorinë e ushqimeve).

Ndërkohë, duke vëzhguar kolonën e tretë paraqiten vlera të larta të Gini-t të komponentit. Sa më e ulët vlera aq më shumë ka të ngjarë që shpenzimet të jenë të shpërndara në mënyrë të barabartë relativisht me shpenzimet e tjera dhe sa më e lartë vlera, aq më pak ka të ngjarë që shpenzimet të jenë të shpërndara në mënyrë të barabartë relativisht me shpenzimet e tjera. Argëtimi, mobiliet dhe pajisjet shtëpiake kanë një vlerë të Gini-t pothuajse 1, që do të thotë se probabiliteti që shpenzimet në këto kategori të jenë të shpërndara në mënyrë të barabartë është mjaft i ulët. Koeficientin më të ulët e ka kategoria "karburant, energji, ujë", ndjekur nga mirëmbajtja dhe operimi dhe më pas nga ushqimi, të cilat në përgjithësi janë shpenzime të nevojshme për familjet.

Ndërkohë, siç duket në kolonën 1, janë komponentët që kanë një Gini më të ulët ato që kanë kontribuar më së shumti në llogaritjen e vlerës totale të Gini-t, përkundrejt komponentëve me një Gini të lartë, që nënkupton një ulje artificiale të Gini-t të totalit. Ushqimi; mirëmbajtja dhe operimi; dhe karburanti, energjia, uji kanë koeficientin më të ulët dhe njëkohësisht janë dhe kontribuesit kryesorë në vlerën e pabarazisë totale (shih kolonën 5, lk). Ndërkohë, mobiliet dhe pajisjet; transporti dhe argëtimi kanë Gini-n e komponentit më të lartë, por edhe kontributin më të ulët në pabarazinë totale.

**Në të vërtetë, pjesa më e madhe e shpenzimeve totale përbëhet nga shpenzimet për ushqim, karburant, ujë, energji, si dhe mirëmbajtje dhe operim, të cilat përbëjnë dhe 76% të shpenzimeve totale të familjeve.** Ndërkohë në anën tjetër, komponentët e tjerë zënë një peshë të vogël të shpenzimeve të familjeve, për shembull argëtimi përbën vetëm 3% të totalit të shpenzimeve të një familjeje duke sugjeruar se shpenzimet e domosdoshme (dhe si të tilla pasqyrohen edhe në kolonën e fundit të elasticiteteve) përbëjnë pjesën dërmuese të shpenzimeve të familjeve dhe kjo shpjegon dhe vlerat e llogaritura të Gini-t dhe të kontributeve përkatëse.

Pra, në këtë kontekst, pavarësisht vlerës së ulët të Gini-t të totalit, koeficienti Gini për komponentët e shpenzimeve nuk duhet anashkaluar pasi është një shpjegues më i mirë i pabarazisë sesa koeficienti total.


Tabela 1. Rezultatet: Dekompozimi i koeficientit Gini (LSMS 2012)

Komponenti i shpenzimeve	Kontributi në totalin e pabarazisë (Gk)	Korrelacioni me shkallën e shpenzimeve totale (Rk)	Gini i komponentit (Gk)	Kontributi i shpenzimeve (Sk)	Kontributi i pabarazisë në shpenzime (lk)	Pabarazia relative e shpenzimeve (lk/Sk)	Efektet relative marxhinale (lk-Sk)	Elasticiteti (Rk*Gk)/G
Ushqimi	0.090	0.636	0.484	0.292	0.243	0.832	-0.049	0.830
Transporti	0.012	0.449	0.888	0.030	0.032	1.067	0.002	1.074
Argëtimi	0.027	0.788	0.906	0.038	0.072	1.894	0.034	1.924
Alkooli dhe Duhani	0.033	0.555	0.799	0.074	0.089	1.203	0.015	1.195
Mirëmbajtja dhe operimi	0.083	0.756	0.477	0.230	0.224	0.974	-0.006	0.972
Veshja dhe shërbimet	0.019	0.611	0.596	0.054	0.051	0.944	-0.003	0.982
Mobiljet dhe pajisjet	0.011	0.670	0.923	0.017	0.030	1.765	0.013	1.667
Karburanti, Energjia, Uji	0.083	0.742	0.469	0.238	0.224	0.941	-0.014	0.938
Shpenzime të tjera	0.013	0.536	0.818	0.029	0.035	1.207	0.006	1.182
Total	0.371	1.000	0.371	1.000	1.000	1.000	0.000	

Burimi: Llogaritjet e autorit.

Së dyti, duke analizuar elasticitetet në kolonën e fundit, mund të shohim se argëtimi i cili siç e përmendëm përbën vetëm 3% të shpenzimeve totale ka një koeficient elasticiteti ndjeshëm më të lartë se 1, duke treguar se ky mall konsiderohet një mall luksi. E njëjta gjë vlen dhe për mobiljet dhe pajisjet shtëpiake, transportin, alkoolin dhe duhanin. Duke u bazuar në këtë grupim të mallrave dhe shërbimeve, asnjë komponent nuk shfaq tendencë të mallrave inferiorë, pasi këto kategori janë mjaft të gjera dhe të shumëllojshme dhe efekti agregat mund të zbehë efektet për një ose dy mallra që perceptohen si të tilla. Vlera e elasticitetit është e ndikuar ndjeshëm nga vlerat e korrelacionit me shkallën e shpenzimeve totale ( $R_k$ ) dhe nga Gini i komponentit ( $G_k$ ). Një korrelacion i lartë dhe një Gini i lartë rezultojnë që të mirat dhe shërbimet të shfaqin një elasticitet të lartë përkundrejt shpenzimeve. Veçanërisht ushqimi, argëtimi, mirëmbajtja dhe operimi, karburanti energjia dhe uji, janë relativisht joelastike, ndërkohë që argëtimi, mobiljet dhe pajisjet shtëpiake janë relativisht elastike.

Më poshtë është paraqitur një skicë e kurbave të Engels-it për secilin komponent të shpenzimeve totale, duke u bazuar në vlerat e elasticiteteve. Për efekt krahasimi, të gjitha kurbat janë ndërtuar në të njëjtin grafik. Këto kurba paraqesin lidhjen midis të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kanë pjerrësi pozitive. Matja e elasticitetit shmang nevojën për përfshirjen e të dhënave mbi të ardhurat e familjeve në analizë.



Kurbat e Engels-it për mallrat e luksit ( $E > 1$ ) fillojnë në boshtin horizontal, që nënkupton se deri në një nivel të caktuar të të ardhurave të familjes këto mallra nuk konsumohen. Ndërsa për mallrat e domosdoshme ( $E < 1$ ), kurbat e Engels-it fillojnë në boshtin vertikal, që nënkupton se edhe kur të ardhurat janë zero këto mallra konsumohen nga familjet në sasi pozitive dhe kurba 45° që përfaqëson  $E=1$  fillon nga origjina. Pikëprerja nuk nënkupton domosdoshmërisht që këto kurba do të priten me vijën 45° në të njëjtën pikë, por është përdorur për të lehtësuar vizualizimin e tyre.

Së fundi, efektet relative marxhinale të paraqitura në kolonën (7) flasin për mundësinë se si një rritje në shpenzimet për një komponent të caktuar të shpenzimeve mund të sjellë një ulje të pabarazisë. Për këtë  $lk > Sk$ , pra koeficienti i paraqitur në tabelë, duhet të ketë një vlerë negative. Një vlerë pozitive e koeficientit nënkupton se një rritje e shpenzimeve për këtë komponent do të sjellë një rritje të pabarazisë. **Në rastin tonë, një rritje në shpenzimet për ushqim; mirëmbajtje, operim; veshje dhe shërbime; dhe karburant, energji dhe ujë do të sjellë ulje të pabarazisë.** Një rritje në shpenzime për këto kategori mund të vijë nga ulja e taksave për produktet dhe shërbimet kryesore ose nga politika të tjera lehtësuese ose nxitëse. Gjithashtu, taksimi ose politika shtrenguese për komponentët e tjerë, të cilët kanë një vlerë pozitive të efekteve relative marxhinale do të sjellë të njëjtin rezultat, pra një ulje të pabarazisë në shpenzime.

## KONKLUZIONE

Artikulli gjen një koeficient Gini për të ardhurat prej 0,403% dhe një koeficient Gini për shpenzimet prej 0,371%, dy vlera të cilat sugjerojnë se sjellja e shpenzimeve është e ndikuar nga të ardhurat, por pabarazia në shpërndarjen e shpenzimeve është më e ulët se ajo në shpërndarjen e të ardhurave. Megjithatë, pabarazia thellohet duke llogaritur vlera të dekompozuar të koeficientit për komponentët e shpenzimeve totale. Në Shqipëri, 78% e shpenzimeve totale i referohen shpenzimeve në bazë të familjeve, gjë e cila ndikon në uljen artificialisht të vlerës së Gini-t. Komponentët e veçantë të shpenzimeve si argëtimi, transporti, mobilitet dhe pajisjet përbëjnë një pjesë shumë të vogël të shpenzimeve mesatare të familjeve e për rrjedhojë kanë një probabilitet pothuajse 1 për të qenë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në popullatë. Në këtë kontekst, dekompozimi i koeficientit sipas kategorive të caktuara të të mirave dhe shërbimeve jep më tepër informacion për pabarazinë, fuqinë blerëse dhe konsumin.

Në të vërtetë, vetëm mallrat dhe shërbimet primare shpenzohen si mallra të domosdoshme dhe çdo shpenzim tjetër përfshirë argëtimin, transportin, veshjet etj., konsiderohen shpenzime luksi në popullatë dhe kontributi për to është i ulët në një numër të madh familjesh. Duke qenë se kjo analizë nuk merr në konsideratë të ardhurat, çmimet apo karakteristikat e familjeve, nuk është e mundur të jepet një shpjegim për ekuilibrat e optimizimit të shpenzimeve të familjeve.

Këto gjetje sugjerojnë për heterogjenitet në të ardhurat dhe shpenzimet e familjeve dhe për impaktin e rëndësishëm që mund të kenë politikat e qëndrueshme dhe lehtësuese gjë e cila duhet të merret në konsideratë në analizën dhe vendimmarrjen e politikës monetare dhe stabilitetit financiar në terma afatgjatë. Në vende në zhvillim si Shqipëria, ku shpenzimet janë të orientuara drejt produkteve dhe shërbimeve të domosdoshme, luhatjet e tregut kanë një ndikim të madh në shpenzime, mirëqenie, si dhe në nivelin e borxhit të familjeve [Cirera, Masset (2010)].



## REFERENCA

- Bernanke, B. (1993), "Credit in the Macroeconomy", FRBNY Quarterly Review, Spring, pp 50-70
- Burtless, G. (1995), "International Trade and the Rise in Earnings Inequality", Journal of Economic Literature, 33, 800-816.
- Cirera, X., Masset, E. (2010), "Income distribution trends and future food demand", Philosophical Transaction of the Royal Society, 365, pp 2821-2834
- Cutler, M.D., Katz, F.L. (1992), "Rising inequality? Changes in the distribution of income and consumption in the 1980s", NBER Working paper #3964
- Daunfeldt, O.S., Folster, S. Hortlund, P (2007), "Consumption and Income Inequality in Sweden: A different story",
- Garner, I.T. (1993), "Consumer Expenditures and Inequality: An Analysis Based on Decomposition of the Gini Coefficient", The Review of Economics and Statistics, Vol.75, No. 1, pp 134-138
- Gini, C. (1936). "On the Measure of Concentration with Special Reference to Income and Statistics", Colorado College Publication, General Series No. 208, 73-79.
- Gottschalk, P., and T.M. Smeeding (1997), "Cross National Comparisons of Earnings and Income Inequality", Journal of Economic Literature, 35, 633-687.
- Instat, "Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës 2012", të dhënat mikro të anketës: <http://www.instat.gov.al/al/figures/t%C3%AB-dh%C3%ABna-mikro.aspx>, aksesuar në 30.05.2017
- Instat, "Llogaritë Kombëtare Vjetore (Metoda e Shpenzimeve) 1996-2015", <http://www.instat.gov.al/al/themes/llogarit%C3%AB-kombetare.aspx?tab=tabs-5>, aksesuar në 30.05.2017
- Krueger, D., Perri, F. (2005), "Does income inequality lead to consumption inequality?", Federal Reserve Bank of Minneapolis, Research Department Staff Report 363
- Lerman, I., Yitzhaki, Sh. (1984), "A note on the calculation and interpretation of the Gini index", Economics Letters 15, 363-368
- Levy, F., and Murmane, R.J. (1992), "U.S. Earnings Levels and Earnings Inequality: A Review of Recent Trends and Proposed Explanations", Journal of Economic Literature, 30, 1333-1381.
- Meyer, B.D., and Sullivan, J.X. (2003), "Measuring the Well-Being of the Poor Using Income and Consumption", Journal of Human Resources, 38, 1180-1220.
- Meyer, B.D., and Sullivan, J.X. (2006), "Consumption, Income, and Material Well-being after Welfare Reform", NBER Working Paper No. 11976.

Tabela 2. Mallrat dhe shërbimet pjesë e komponentit të shpenzimeve totale

Komponenti	Mallrat dhe Shërbimet
Ushqimi	Ushqime brenda shtëpisë Ushqime jashtë shtëpisë
Transporti	Transporti rrugor (autobus, furgon, taksi) ose hekurudhor Transporti detar, ujqor Transporti ajror
Argëtimi	Zbavitje (kinema, teatër, opera, koncerte, cirk, aktivitete muzikore, sport) Pushime brenda dhe jashtë vendit Ekskursione Libra, Gazeta, Revista Sport dhe pajisje për hobby
Alkooli dhe Duhani	Alkooli dhe Duhani
Mirëmbajtja dhe Operimi	Telefoni fiks Interneti Artikuj të kujdesit personal Artikuj për pastrimin e shtëpisë Shërbime shtëpiake (kujdesi për fëmijët dhe të moshuarit, pastrimi etj.) Pastrim kimik Shërbime postare Ushqim dhe shërbime për kafshët shtëpiake Kurse jashtëshkollore
Veshja dhe Shërbimet	Veshje dhe këpucë për burra Veshje dhe këpucë për fëmijë Veshje dhe këpucë për gra Aksesorë mode Rrobaqepës Metrazhe dhe sende për qepje/thurje Shërbime bankare, noteriale etj. Shërbime të kujdesit personal
Mobiljet dhe Pajisjet	Rinovime, riparime, mirëmbajtje e banesës Mobiliet Pajisje të vogla elektrike dhe joelektrike Pajisje të mëdha elektrike dhe joelektrike Enë kuzhine Roba për shtëpinë
Karburanti, Energjia, Uji	Karburante Energji Ujë
Shpenzime të tjera	Dhurata Transferta jashtë familjes Bamirësi Humbje në kumar Shpenzime për festa familjare Shpenzime të tjera 1-mujore, 6-mujore, 12-mujore